



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i auditimit të Performancës

**Vendimmarrjet lidhur me strukturën organizative dhe Alpex
dega në Kosovë – Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe
Tregut - KOSTT sh.a.**

Prishtinë, Shtator 2021

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000) si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë , efikasitetit dhe efektivitetit dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit “Vendimmarrjet lidhur me strukturën organizative dhe Alpex dega në Kosovë – Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut -KOSTT” në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme, Arvita Zyferi-Hashani, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi raportin:

Enver Boqolli, udhëheqës i ekipit të auditimit

Fikret Ibrahim, anëtar i ekipit

Ramadan Gashi, anëtar i ekipit

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	i
1 Hyrje.....	1
1.1 Objektiva e auditimit.....	2
1.2 Pyetjet dhe kriteret e auditimit	2
2 Gjetjet e auditimit.....	4

Lista e shkurtesave

ALPEX	Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike
BD	Bordi i Drejtorëve
KOSTT	Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut
OST	Operatori i Sistemit të Transmisionit
UA	Udhëzim Administrativ
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

Përmbledhje e përgjithshme

Ky auditim është kryer bazuar në kërkesën e Kuvendit të Kosovës të datës 12 gusht 2021 drejtuar Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA). Kuvendi i Kosovës kishte rekomanduar auditimin e performancës së vendimeve të Operatorit të Transmisionit, Sistemit dhe Tregut sh.a (tutje: KOSTT) lidhur me strukturën e brendshme organizative dhe vendimet e ALPEX dega, në Kosovë.

Bazuar në rekomandimet e lartcekura, Zyra Kombëtare e Auditimit ka vlerësuar nëse vendimet lidhur me strukturën organizative të KOSTT janë sipas kriterëve të vendosura në legjislacion, statut të ndërmarrjes, rregullore dhe akte tjera që rregullojnë organizimin e menaxhimit të ndërmarrjeve publike në vend. Po ashtu, ka vlerësuar nëse vendimet e APLEX-it dega në Kosovë janë në pajtim me aktet e saj dhe në drejtim të arritjes së rezultateve më të mira.

Rezultatet e auditimit kanë treguar se, KOSTT ka një strukturë organizative përmes së cilës përshkruan nivelet hierarkike, funksionet e njësisve organizative dhe aktivitetet e kompanisë. Këto aktivitete përfshijnë rregulla, role dhe përgjegjësi. Në strukturë organizative gjithashtu është përcaktuar edhe raportimi midis niveleve brenda ndërmarrjes. Megjithatë, auditimi ka identifikuar disa mangësi gjatë vendimmarrjes lidhur me strukturën organizative dhe proceseve përcjellëse të saj. Në veçanti, mangësitë kanë të bëjnë me themelimin e pozitave të reja jashtë strukturës organizative, mungesa e një analize dhe arsyeshmërie të mirëfilltë lidhur me nevojën për ndryshime si dhe avancimi në pozita të ndryshme në KOSTT duke anashkaluar procedurat e parapara për mbulimin e këtyre pozitave.

Më tutje, lidhur me vendimet e ALPEX dega në Kosovë, rezultatet e auditimit kanë treguar se vendimmarrja në përgjithësi ishte e bazuar në harmoni me marrëveshjen e aksionarëve të KOSTT.sh.a. dhe OST.sh.a. dhe në përputhje me Statutin e ALPEX.sh.a. Megjithatë, mungesa e një procedure formale për zgjedhjen dhe emërimet e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të ndryshëm ka ndikuar që në raste të caktuara përzgjedhja e kandidatëve për pozita menaxheriale të bëhet pa procese transparente dhe konkurruese.

Me qëllim të përmirësimit të procesit vendimmarrës lidhur me strukturën organizative dhe vendimet lidhur me APLEX, kemi dhënë pesë rekomandime për KOSTT të cilat i gjeni në brendi të raportit të auditimit.

Përgjigja e menaxhmentit

KOSTT është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe janë zotuar se do t'i adresojnë rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut sh.a, operon si entitet i pavarur nga dhjetori i vitit 2005 nga transformimi i Korporatës Energjetike të Kosovës. Aktiviteti kryesor i KOSTT-it është menaxhimi dhe operimi i sistemit të transmisionit dhe energjisë së Kosovës, si dhe është përgjegjëse për transmisionin e energjisë tek rrjetet elektrike të tensionit të lartë. Si operator tregu, KOSTT-i është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregtisë së energjisë dhe gjithashtu menaxhon procesin e marrëveshjeve të shit-blerjeve të energjisë elektrike në Kosovë.

Struktura organizative e KOSTT-it, përbëhet nga nëntë departamente që mbulojnë 31 sektorë (Shtojca 1). Departamentet të cilat mbulojnë afarizmin themelor teknik-operativ të KOSTT-it janë: Operatori i Transmisionit, Operatori i Sistemit, Operatorit i Tregut, Financat dhe Thesari, Prokurimi, Zhvillimi i Rrjetit dhe Projekteve, Çështjet Rregullative dhe Tarifat, Burimet Njerëzore dhe Shërbimet Përkrahëse. Përveç këtyre në drejtorinë qendrore janë të lidhura edhe zyrat për: planifikim afatgjatë, për komunikim dhe relacione me publikun dhe zyra ligjore. Kriteret për organizimin e brendshëm të KOSTT-it bazohen në legjislacion, udhëzime administrative, rregullore dhe standarde tjera që rregullojnë administrimin dhe organizimin e menaxhimit të kompanive publike në vend.

Bursa shqiptare e energjisë elektrike sh.a (Tutje: ALPEX) është themeluar si një domosdoshmëri e ekzistimit të një tregu të përbashkët energjetik Shqipëri – Kosovë, si dhe një nga objektivat e pakos së tretë të direktivave të Bashkimit Evropian për themelimin e Tregut të Brendshëm Evropian të Energjisë Elektrike. Po ashtu, vendimet e arritura në kuadër të Procesit të Berlinit përkatësisht në Samitin e Ballkanit Perëndimor në Vjenë ishin pjesë e themelimit të operatorit (bursës) për operimin dhe rrjedhimisht bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike në një treg rajonal. ALPEX-i ka për synim organizimin e tregut të energjisë elektrike Shqipëri-Kosovë dhe bashkimin e këtij tregu në të njëjtën kohë duke mundësuar integrimin e plotë me synim përfitimin e konsumatorëve të të dyja vendeve duke optimizuar shfrytëzimin e burimeve prodhuese. Diversiteti i prodhimit dhe kapacitetet transmetuese ndërkufitare mundësojnë integrimin e plotë të tregjeve në të gjitha afatet kohore të tregtimit për të rritur sigurinë e furnizimit.

ALPEX është themeluar si një shoqëri aksionare në pronësi të OST sh.a dhe KOSTT sh.a., e regjistruar në Shqipëri, me seli në Tiranë. Statuti i saj ishte miratuar me 05 tetor 2020. OST sh.a përfaqëson 57.25% të aksioneve, ndërsa KOSTT 42.75%. Kjo bursë shërben për të siguruar më shumë transparencë dhe konkurrencë në tregun e energjisë elektrike. Për më tepër, qëllimi i saj është të ndikojë në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, shfrytëzimin më efikas të kapaciteteve ndërkufitare si dhe pritjet që të ketë ndikim në uljen e çmimit të energjisë elektrike për qytetarët e të dyja vendeve: Kosovës dhe Shqipërisë. Themelimi i kësaj burse të energjisë elektrike gjithashtu është

në përputhje me politikat e dy vendeve për liberalizim të tregut të energjisë dhe rritjen e transparencës dhe konkurrueshmërisë në këtë treg.

Themelimi i ALPEX dega në Kosovë është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i ALPEX me datë 27 janar 2021 si pjesë e ALPEX me të gjitha të drejtat dhe obligimet që dalin nga Statuti dhe aktet tjera që i nxjerrë Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Mbikëqyrës.

1.1 Objektiva e auditimit

Objektivë e parë e këtij auditimi ishte vlerësimi nëse vendimet lidhur me strukturën organizative të KOSTT janë sipas kriterëve të vendosura në legjislacion, statut të ndërmarrjes, rregullore dhe akte tjera që rregullojnë organizimin e menaxhimit të ndërmarrjeve publike në vend. Vendimet lidhur me strukturën organizative të KOSTT-it do të vlerësohen nëse janë të bazuara në analiza të duhura paraprake ku përfshihen edhe ato kost-benifitit të argumentuara mirë.

Objektivë e dytë e këtij auditimi ishte të vlerësojmë nëse vendimet e ALPEX-it dega në Kosovë kanë qenë në pajtim me aktet e saj dhe në drejtim të arritjes së rezultateve më të mira.

Fushëveprim i këtij auditimi ishte struktura organizative në fuqi dhe proceset e saj përcjellëse si dhe vendimet e ALPEX dega në Kosovë që nga themelimi deri në kryerjen e këtij auditimi.

Përmes këtij auditimi aty ku ishte e nevojshme, kemi ofruar rekomandime për përmirësimin e sistemit vendimmarrës me qëllim që procesi të siguroj se të gjitha vendimet janë të bazuara në analiza paraprake, të dokumentuara mirë dhe janë në shërbim të sigurimit të një tregu transparent i cili mundëson konkurrencë në tregun e energjisë elektrike.

1.2 Pyetjet dhe kriteret e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit ne kemi parashtruar pyetjet, nën-pyetjet e auditimit. Kriteret e përdorura në këtë auditim rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, statuti i NP, standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikat e mira.

1. *A janë vendimet lidhur me strukturën organizative të KOSTT SH.A. në harmoni me legjislacionin në fuqi?*

1.1 *A janë marrë vendimet lidhur me strukturën organizative të KOSTT SH.A. bazuar në analizat e duhura dhe të mjaftueshme në mënyrë që të sigurojnë cost-benifit të këtyre vendimeve?*

Vendimet lidhur me strukturën e brendshme organizative të KOSTT-t duhet të jenë të qarta dhe gjithëpërfshirëse, në harmoni me ligjet e vendit, Statutin e ndërmarrjes dhe vendimet e BD të saj, duke pasur parasysh objektivat organizative dhe funksionale të kësaj NP-je.

KOSTT Sh.a duhet të zhvillojë një sistem ku të gjitha vendimet për strukturën e brendshme organizative merren në bazë të analizave paraprake. Analizat e duhura dhe të mjaftueshme bëhen me kohë në mënyrë që vendimet lidhur me strukturën organizative të jenë gjithëpërfshirëse. Kjo nënkupton përfshirjen e analizave të thukëta që shqyrtojnë rreziqe të ndryshme, duke përshkruar mjetet dhe mekanizmat e duhura për të adresuar boshllëqet dhe për të reflektuar gjendjen duke argumentuar kost-benefitin për vendimet.

2. *A janë vendimet e ALPEX dega në Kosovë në harmoni me rregulloret në fuqi?*

2.1 *A janë marrë vendimet lidhur me ALPEX-in dega në Kosovë bazuar në analizat e duhura, të mjaftueshme dhe me kohë në mënyrë që të sigurojnë cost-benefit të këtyre vendimeve?*

Vendimet e ALPEX dega në Kosovë, duhet të jenë në harmoni me rregulloret në fuqi dhe shërbejnë për të siguruar më shumë transparencë dhe konkurrencë në tregun e energjisë elektrike, të ndikojnë në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, shfrytëzimin më efikas të kapaciteteve ndërkufitare si dhe mund të kenë ndikim në uljen e çmimit të energjisë elektrike për qytetarët e të dyja vendeve.

Të gjitha vendimet e ALPEX-it dega në Kosovë duhet të merren në bazë të analizave të duhura dhe me kohë për të siguruar qartë përfitimet e këtyre vendimeve.

2 Gjetjet e auditimit

Në këtë kapitull janë paraqitur gjetjet dhe rekomandimet e auditimit që kanë të bëjnë me strukturën organizative të KOSTT dhe me vendimet e ALPEX.sh.a.

Çështjet lidhur me vlerësimin e vendimeve për Strukturën organizative të KOSTT

Mungesë arsyeshmërie në krijimin e pozitave të reja në strukturë organizative

Skema organizative dhe hierarkike e KOSTT-it përbëhet nga Makro-struktura e propozuar nga KE dhe e aprovuar nga Bordi i Drejtorëve (BD) e cila ishte në përputhje me politikën mbi nivelin e autorizimeve në KOSTT.

Niveli i parë hierarkik paraqet nivelin më të lartë në KOSTT, i cili përbëhet nga BD që udhëhiqet nga Kryesuesi i BD dhe katër drejtorë (anëtarë bordi), si dhe 4 zyrtarë të lartë të NP- KOSTT. Bazuar në nenet 15.1 dhe 21.3 të Ligjit për NP, çdo ndërmarrje publike qendrore duhet të ketë BD në përbërje prej 5 ose 7 anëtarë. Po ashtu, neni 21.3 i Ligjit për NP përcakton, se secila NP do të ketë këta katër zyrtarë në vijim: Kryeshefin Ekzekutiv, Zyrtarin Kryesor Financiar dhe të Thesarit, Këshilltarin e Përgjithshëm/Sekretarin e Korporatës dhe Zyrtarin për Auditim të Brendshëm. Për më tepër, NP mundet - nëse vendoset nga Bordi i Drejtorëve dhe përcaktohet në Rregullore që po ashtu të ketë një ose dy poste të Zëvendës Kryeshefit.

Në rishikimin e strukturës organizative të KOSTT-it, kemi vërejtur që makro-struktura është në përputhje me ligjin për NP-të, respektivisht ka BD funksional (edhe pse jo të plotë) si funksioni më i lartë mbikëqyrës dhe ka katër (4) zyrtarë kryesor të kompanisë. Për shkak të kompleksitetit të ndërmarrjes me vendim të BD-së është lejuar edhe posti i zëvendës-kryeshefit ekzekutiv.

Niveli i dytë hierarkik është niveli i drejtorëve të departamenteve në KOSTT me përbërje të 9 departamenteve. Niveli i tretë hierarkik në makro-strukturë organizative është niveli i menaxhimit të sektorëve. Secili sektor në KOSTT menaxhohet - udhëhiqet nga një menaxher. Gjithsejtë janë 31 sektorë të shpërndarë në nëntë (9) departamente varësisht prej ndërlidhjes së funksioneve dhe proceseve të punës.

Ndryshimet në sektorin e energjisë kanë reflektuar nevojën për ndryshime dhe plotësime në makro strukturë. Këto ndryshime dhe zhvillime kanë ndikuar edhe në ndryshimin e vazhdueshëm të përshkrimeve të vendeve të punës, si dhe ndryshime-plotësime të funksioneve të reja.

Bazuar në dokumentacionin e ekzaminuar gjatë procesit të auditimit, KOSTT ka bërë ndryshime të mëdha në strukturën e saj organizative gjatë viteve 2017 dhe 2018.

Procesi i ndryshimit të strukturës organizative për vitin 2017

Struktura organizative e cila ishte në funksion dhe subjekt i këtij auditimi ishte propozuar nga Kryeshefi ekzekutiv, e cila strukturë ishte aprovuar njëzëri nga BD¹.

Kemi vërejtur se vendimi i marrë nga BD nuk kishte ndonjë arsyeshmëri/analizë mbi nevojën për riorganizim, ndërsa pjesë integrale e këtij vendimi ishte edhe organogrami. Në organogram kemi vërejtur se struktura përbëhet prej BD-së, katër (4) zyrtarëve të lartë të përcaktuar me ligjin e NP-ve, dy zëvendës kryeshefeve ekzekutiv dhe tre (3) zyrtarëve të zyrave që i përgjigjen zëvendës kryeshefeve. Në organogram vërehet që KOSTT-i në nivel të drejtorëve të departamenteve përbëhet prej tetë (8) departamenteve dhe 29 sektorëve.

Mbështetur në vendimin e BD dhe propozimin për riorganizim, kryeshefi ekzekutiv kishte nxjerr vendim² mbi ndryshimet e organizimit të KOSTT në nivel të sektorëve duke i bartur nga një departament në tjetrin disa sektorë.

Në strukturën organizative të miratuar nga BD³ ishin paraparë pozitat e zëvendës kryeshefave ekzekutiv të cilët i përgjigjen kryeshefit ekzekutiv, por pa arsyeshmëri për krijimin e këtyre dy pozitave.

Procesi i ndryshimit të strukturës organizative për vitin 2018

Sipas procesverbalit të takimit⁴ KE kishte propozuar ndryshimet në strukturën organizative duke u thirrur në nevojën për përshtatje të rrethanave të reja në KOSTT dhe si rrjedhojë e rekomandimeve të konsulencës financiare nga BERZH-i. Pas diskutimeve dhe arritjes së konsensusit, BD njëzëri miratoi riorganizimin e brendshëm të KOSTT-it (ndryshim i makro skemës organizative)⁵.

Në organogram kemi vërejtur se struktura përbëhet nga BD, 4 zyrtarë të lartë të përcaktuar me ligjin e NP-ve, një zëvendës kryeshef ekzekutiv (për dallim nga struktura e vitit 2017 ku ishin të përcaktuar 2 pozita të tilla) dhe tre (3) zyra që i përgjigjen zëvendës kryeshefit, si dhe një menaxher për cilësi dhe politika që i përgjigjet zëvendës kryeshefit ekzekutiv.

Në organogramin e vitit 2018, KOSTT përbëhej nga nëntë (9) departamente, pra ishte themeluar një departament i ri me emrin - Departamenti i shërbimeve përkrahëse, si dhe 31 sektorë dhe dy (2) koordinator në nivel të sektorëve.

¹ Në mbledhjen e mbajtur me datë 19.05.2017

² Nr. 545 të datës 29.05.2017

³ Me vendimin 170515-II/5 nr. 495 të datës 19.05.2017 të BD

⁴ Në mbledhjen e mbajtur me datë 23.07.2018 me procesverbalin nr. 103/18, të pikës 3 të diskutimit lidhur me çështjen e strukturës organizative

⁵ Vendimi nr. 180425-II/3.

Bazuar në vendimin e bordit, KE kishte nxjerr vendim⁶ mbi ndryshimin e organizimit në nivel të sektorëve, ku parashihej lëvizja e sektorëve nga një departament në mbikëqyrjen dhe domenin e një departamenti tjetër pa ndonjë arsyeshmëri apo analizë mbi këto ndryshime.

Gjatë procesit të auditimit është vërejtur se me vendimin e kryeshefit ekzekutiv për strukturën e re organizative ishin paraparë dy (2) pozita të koordinatorëve, mirëpo nuk kemi vërejtur arsyeshmëri/analizë mbi themelimin e këtyre pozitave dhe mbi nevojën për këto funksione.

Koordinatorët janë caktuar me vendim të kryeshefit ekzekutiv si ushtrues detyre, megjithatë pas një periudhe kohore iu është dhënë kontratë pune me kohë të pa caktuar, pa ndonjë procedurë të hapur dhe konkurruese. Rastet si në vijim:

-Me datën 04.05.2018⁷, kryeshefi ekzekutiv ka caktuar u.d koordinatorin për planifikim dhe operativë në Departamentin e operimit të sistemit në KOSTT, dhe

-Me datën 22.05.2018⁸ kryeshefi ekzekutiv ka caktuar u.d koordinatorin për përkrahje të sistemit në Departamentin e shërbimeve përkrahëse në KOSTT.

-Po ashtu, kemi vërejtur se me datën 28.01.2021⁹ kryeshefi ekzekutiv ka themeluar pozitë të re për koordinator për operimin e transmisionit në Departamentin e operatorit të transmisionit edhe për kundër faktit se kjo pozitë nuk është paraparë në strukturën organizative në fuqi¹⁰.

Rekomandimi 1

Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që çdo ndryshim në strukturën organizative t'i paraprij një analizë dhe arsyeshmëri e mirëfilltë mbi nevojën për ndryshime eventuale dhe të njëjtat të shqyrtohen dhe miratohen nga nivelet hierarkike të autorizuara për këto vendime. Po ashtu, të ushtrojë mbikëqyrje rigoroze ndaj ndryshimeve të rëndësishme në nivel të kompanisë duke u siguruar që personat përgjegjës për menaxhimin e kompanisë nuk marrin vendime për të cilat nuk janë të autorizuar.

⁶ Vendimi nr. 506/01- dt. 03.05.2018

⁷ Vendimi nr. 538/01-dt. 04.05.2018

⁸ Vendimi nr. 650 – dt. 22.05.2018

⁹ Vendimi nr. 164 – dt. 28.01.2021

¹⁰ Vendimi nr. 164 – dt. 28.01.2021

Promovimi/avancimi i personelit në pozita drejtuese pa procedura konkurruese

Bazuar në Udhëzimin Administrativ¹¹ për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, përkatësisht neni 4, paragrafi 6 përcakton se: Organi përkatës i autorizuar me statut apo aktin e brendshëm duhet fillimisht të shpall konkurs të brendshëm, nëse ka më shumë se një kandidat të cilët i plotësojnë kushtet e kërkuara për plotësimin e vendit të lirë të punës.

Referuar pikës 6.1 të Politikës së Rekrutimit dhe selektimit e aprovuar nga BD¹² përcaktohet se: Nëse për vendin e lirë të punës ka më shumë se një kandidat brenda Kompanisë të cilët i plotësojnë kushtet e kërkuara atëherë duhet që fillimisht KOSTT të shpall konkurs të brendshëm për plotësimin e vendit të lirë të punës. Po ashtu, në pikën 8.1 të politikës së rekrutimit dhe selektimit në KOSTT, në paragrafin e fundit përcaktohet se DBNj duhet të analizojë nëse ka staf të brendshëm që i plotësojnë kushtet dhe kriteret për atë pozitë në mënyrë që të bëhet shpallja e brendshme.

Sipas të dhënave të ofruara nga departamenti i burimeve njerëzore në KOSTT për vitet 2017-2021, numri i zyrtarëve të promovuar/avancuar që ushtrojnë pozita drejtuese pa procedura konkurruese ishte 23, prej të cilave për t'i konfirmuar pohimet e menaxhmentit ne i kemi testuar 5 mostra.

Nga testimet tona kemi vërejtur se gjatë viteve 2017-2021 në pozita drejtuese si Drejtor departamenti, Menaxher të sektorëve dhe Koordinator ishin emëruar me vendime të Kryeshefit Ekzekutiv fillimisht si ushtrues detyre dhe pas një periudhe kohore janë pajisur me kontrata pune me kohë të pacaktuar në pozitat e lartë-përmendura, pa konkurs të brendshëm dhe pa kaluar përmes procedurave të rekrutimit, ashtu siç përcaktohet me UA dhe politikën e rekrutimit dhe selektimit.

Kjo dukuri mund të ketë ndikim në performancën operationale të KOSTT-it, si dhe mund të ndikoj që kandidatët e emëruar të jenë jo-meritor dhe jo kompetent për atë pozitë.

Rekomandimi 2

Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefi Ekzekutiv duhet të sigurojnë që të gjitha rastet e promovimeve dhe avancimeve në pozitat e lira në KOSTT të bëhen përmes konkursit të brendshëm duke respektuar kërkesat e rregullave në fuqi.

¹¹ (MPMS) Nr. 07/2017

¹² Në mbledhjen 101/18 të datës 12 prill 2018 me vendimin 1800412-II/6

Çështjet lidhur me vlerësimin e vendimeve për ALPEX

Nuk ka bazë të qartë ligjore për procesin e emërimeve në Këshillin Mbikëqyrës në ALPEX

Propozimi i dy kandidatëve nga radhët e personelit të KOSTT-it për anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të ALPEX sh.a. ishte bërë nga Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it. Ky propozim ishte aprovuar me vendime¹³ të Bordit të Drejtorëve (BD) të KOSTT sh.a. Po ashtu, edhe lirimi nga detyra dhe emërimi i anëtarit të ri të Këshillit Mbikëqyrës të ALPEX sh.a. ishte bërë bazuar në kërkesën¹⁴ e KOSTT sh.a, e cila është në harmoni me Statutin e themelimit të ALPEX sh.a.

Rregulloret e brendshme të KOSTT sh.a. nuk e kanë të rregulluar se cilat pozita brenda KOSTT-it janë ato të cilat mund të delegohen për përfaqësimin e aksionarit dhe njëherit as nuk ka të rregulluar se cilat duhet të jenë kriteret minimale të cilat duhet t'i përmbushin kandidatët për këto nivele të përfaqësimeve.

KOSTT sh.a. ka bërë emërimin e dy anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të ALPEX sh.a. pa zhvilluar një procedurë konkurruese të hapur dhe transparente për të siguruar se janë deleguar kandidatët me përvojën, kualifikimet dhe njohuritë e duhura për atë vend pune.

Mungesa e një baze të qartë të procedurës dhe përcaktimit të kriterëve të cilat duhet t'i përmbushin kandidatët për tu emëruar nga KOSTT-i për anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të ALPEX sh.a ka ndikuar që mos të zhvillohen procedura adekuate lidhur me këtë proces. Rrjedhimisht, emërimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të ALPEX nga ana e KOSTT-it pa zhvilluar një procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese ndikon në kufizimin e konkurrencës dhe njëherit mund të ndikoj në mos emërimin e kandidatëve adekuat në këto dy pozita.

Rekomandimi 3

Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it të hartoj rregullore të cilat përcaktojnë procedurat e përzgjedhjes dhe kriteret profesionale të nevojshme të kandidatëve për pozitën e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të ALPEX.

BD i KOSTT-it të aprovoj propozimet e Kryeshefit Ekzekutiv për emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë aksionare ALPEX vetëm pasi të jetë siguruar se përzgjedhja e kandidatëve është bërë përmes një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues.

¹³ Vendimi nga mbledhja e BD nr. 116/20; Vendimi 201002-II/6 dhe Vendimi 201002-II/6.1

¹⁴ Kërkesa nr. 1339 e datës 14/07/2021

Pozicionimi jo adekuat i ALPEX dega në Kosovë në strukturën organizative të Shoqërisë Aksionare

Me marrëveshjen e aksionarëve për krijimin e bursës shqiptare të energjisë elektrike janë rënë dakord që ALPEX në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve të saj të themelojë degë ose zyre përfaqësimi në Kosovë. Sipas kësaj marrëveshje me “degë” nënkuptohet një vend i ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe ka të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë e cila vepron në mënyrë të qëndrueshme, organizohet dhe administrohet më vete dhe ushtron veprimtari me palë të treta në emër të shoqërisë.

Këshilli Mbikëqyrës ka aprovuar strukturën organizative të ALPEX sh.a.¹⁵, të prezantuar nga Administratori i Shoqërisë (Shtojca 2).

Rregullorja e funksioneve dhe kritereve për pozicionet në punë të ALPEX sh.a. është hartuar nga Administratori i Shoqërisë¹⁶, ndërsa ishte aprovuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë¹⁷. Menaxheri i Tregut dega në Kosovë/Drejtuuesi i Degës propozohet nga Administratori dhe emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë, mirëpo bazuar në skemën organizative të Shoqërisë Menaxheri i Tregut dega në Kosovë raporton tek Administratori i Shoqërisë dhe Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit të Biznesit, struktura këto hierarkike menaxheriale në selinë e Shoqërisë.

Pozicionimi i ALPEX dega në Kosovë në strukturën organizative të ALPEX sh.a nuk është në pajtim me marrëveshjen e aksionarëve për krijimin e bursës shqiptare të energjisë elektrike ku është specifikuar se degët organizohen dhe administrohen më vete duke ushtruar veprimtari me palët e treta në emër të Shoqërisë.

Strukturimi i pozitës së menaxherit të degës në Kosovë që përveç Administratorit t'i raportoj edhe drejtorit të drejtorisë së zhvillimit të biznesit mund të shkaktoj vështirësi dhe paqartësi në organizimin, funksionimin, natyrën e raportimit dhe përgjegjësisë.

Për më tepër, kjo mënyrë e strukturimit shkakton vështirësi edhe në aspektin e organizimit dhe administrimit, si dhe krijon paqartësi në raportimin lidhur me aktivitetet administrative dhe për veprimtaritë me palë të treta në emër të shoqërisë. Miratimi nga Këshilli Mbikëqyrës i strukturës organizative të ALPEX sh.a. jo në harmoni të plotë me marrëveshjen e aksionarëve për krijimin e bursës shqiptare të energjisë elektrike, përveç vështirësive organizative mund të shkaktoj vështirësi edhe në definimin e qartë të detyrave dhe kompetencave të degës.

Rekomandimi 4

Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it si njëri nga dy aksionarët e ALPEX sh.a. të kërkoj nga Këshilli Mbikëqyrës rishikimin e strukturës organizative të Shoqërisë me qëllim të harmonizimit të

¹⁵ Me datën 19/11/2020 (Vendimi Nr.5)

¹⁶ Me datën 16/11/2020

¹⁷ Me vendimin nr.6 të datës 19/11/2020 (Shtojca 2)

saj në pajtim të plotë me marrëveshjen e aksionarëve për krijimin e bursës shqiptare të energjisë elektrike, ku do të duhej të evitohet raportimin e ALPEX Dega në Kosovë në Drejtorinë e Zhvillimit të Biznesit në ALPEX.

Mungon dokumenti që përcakton procedurat për përzgjedhjen e drejtuesit të ALPEX dega në Kosovë

Këshilli Mbikëqyrës i ALPEX sh.a me datë 27.01.2021 kishte miratuar hapjen e degës dhe aktiviteteve në Kosovë të ALPEX sh.a me të gjitha të drejtat dhe obligimet që dalin nga Statuti dhe aktet tjera që i nxjerrë Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Mbikëqyrës si organet me të larta në ALPEX sh.a. Me autorizimin e këshillit mbikëqyrës, Administratori i ALPEX sh.a me 24.03.2021 kishte aplikuar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) për regjistrimin e degës së ALPEX në Kosovë dhe me 06.05.2021 ishte regjistruar në regjistrin e bizneseve në Kosovë.


Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës me datë 03.06.2021 ishte emëruar drejtuesi i ALPEX sh.a dega në Kosovë dhe meqenëse Asambleja e Përgjithshme ende nuk kishte arritur ta miratojë një procedurë për zgjedhjen dhe emërimin e drejtuesit të degës, Këshilli i kishte kërkuar Asamblesë së Përgjithshme miratimin e propozimit për këtë emërim. Me datë 29.06.2021 Asambleja e Përgjithshme e kishte miratuar emërimin sipas propozimit të Këshillit Mbikëqyrës.

ALPEX dega në Kosovë ende është në fazën e konstituimit dhe funksionalizimit për të vepruar për qëllimin e saj dhe ende (deri më 17.09.2021) nuk ka marr ndonjë vendim apo aktivitet nga veprimtaria e saj. ALPEX dega në Kosovë deri në gusht 2021 kishte vetëm një (1) punonjës, pra vetëm drejtuesin e degës i cili paraprakisht kishte qenë i punësuar në KOSTT dhe me marrjen e kontratës me ALPEX dega në Kosovë kishte shkëputur kontratën e punës me KOSTT-in.

Rekomandimi 5


Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it si njëri nga dy aksionarët e ALPEX sh.a. të kërkojë nga Këshilli Mbikëqyrës nxjerrjen e procedurave për zgjedhjen dhe emërimet e përfaqësuesve të saj në ALPEX dega në Kosovë. Kjo me qëllim të rritjes së konkurrencës dhe transparencës për secilin emërim apo zgjedhje të përfaqësuesve dhe zyrtarëve të ALPEX-it.

SHTOJCA 1. Struktura Organizative e KOSTT sh.a.



SHTOJCA 2. Struktura Organizative e ALPEX sh.a. nëntor 2020

STRUKTURA ORGANIZATIVE E ALPEX sh.a



TOTAL STAF 12

Burimi: Rregullorja e funksioneve dhe kriteret për pozicionet në punë të ALPEX sh.

SHTOJCA 3. Letër Konfirmimi

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C
OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRZIŠTA KOSTT d.d
Nr. 1908 Dt. 29 09 2021
PRISHTINË-A

OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRZIŠTA A.D.



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm me draft raportin e auditimit për “Vendimmarrjet lidhur me strukturën organizative dhe Alpex dega në Kosovë – Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT sh.a”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për auditim të “Vendimmarrjeve lidhur me strukturën organizative dhe Alpex dega në Kosovë – Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT sh.a”, (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Jeton Mehmeti

Kryesues i Bordit të Drejtorëve në KOSTT sh.a.

Data: 29 shtator 2021, Prishtinë

